




|  |            |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO                              |            |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |            |
| Dep.<br>Dip.<br>Dip  | 2-D/DPK    |
| Nr. I taq<br>Broj stranica<br>Nr. pages  | 03         |
| Nr Prot<br>B/ Prot<br>Prot No  | 01-4372/14 |
| Data<br>Datum<br>Date  | 25.11.2014 |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

|                               |   |
|-------------------------------|---|
| <b>DATE/A:</b>                | 25.11.2014  |
| <b>REFERENC-Ë:</b>            | AKK-DPK-12/14   |
| <b>PËR/ZA/TO:</b>             | z. Muhamet Selmani, Anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës   |
| <b>CC:</b>                    |   |
| <b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>  |   |
| <b>NGA/OD/FROM:</b>           | Hasan Preteni,<br>Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit   |
| <b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b> | Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik |

I nderuari z. Selmani,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “*bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave*”, (Neni 19 (paragrafi 1.5) i Ligjit nr.04/L-051), lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Ushtrimi i funksionit si Anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës dhe njëkohësisht Konsulent paraqet kufizim të zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik.

## ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z. Muhamet Selmani – Anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, me numër të protokolit 03-3798/14, në të cilin z. Selmani ka kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e njëkohësishëm të dy funksioneve si Anëtar i Kuvendit Komunal dhe si Konsulent në një Kompani private.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me Ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bënë edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në bazë të këtij Ligji neni 4 (paragrafi 10), pozita e Anëtarit të Kuvendit Komunal hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Nr. 04/L-051, sipas nenit 6 të këtij Ligji, konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Nr.04/L-051, konkretisht në nenin 16 (paragrafi 2), të këtij Ligjit është përcaktuar decidivisht kufizimi i zyrtarit të lartë publik në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik.

Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

Në bazë të kësaj dispozite zyrtari i lartë publik, krahas ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj njëkohësisht veprimtari private si konsulent.

Në anën tjetër, Ligji Nr. 03/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka paraparë deklarin rast për rast të interesave private të zyrtarit të lartë, të përcaktuar shprehimisht në nenin 13 paragrafi (1,2,3) të këtij Ligji në të cilin shprehimisht thuhet:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarinin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Ndërsa, neni 8 (paragrafi 1,2,3,4,5,6) përcakton detyrimet e zyrtarit të lartë për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Ju rekomandojmë, të veproni konform këtij Opinioni të bazuar në Ligj, për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë zyrtarin e lartë në gjendje të konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me respekt!

